

Hapet Thirrja e Katërt për Bursa për studentët në Programin Erasmus + në Universitetin Middle East Technical University, në Ankara, Turqi

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja e katërt për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Middle East Technical University, Ankara, Turqi.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

-Bachelor (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin e Tiranës. Nuk mund të aplikojnë dot studentët e regjistruar në vitin e parë, por ata duhet të jenë të paktën të regjistruar në vitin e dytë të studimeve);

Kohëzgjatja e bursave:

-Bachelor (5 muaj);

Datat e semestrit të dytë: 20 Shkurt 2017 – 26 Maj 2017

Sezoni i provimeve: 29 Maj 2017 – 10 Qershor 2017

Datat e sugjeruara të mbërritjes dhe largimit nga METU: preferohet të shkoni 1 javë para fillimit të semestrit dhe të largoheni nga METU më datë 10 qershor 2017.

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i METU klikoni në adresat: <https://catalog.metu.edu.tr/>

http://oibs3.metu.edu.tr/View_Program_Course_Details_64/main.php

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të originës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës, pra në Universitetin e Tiranës.

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e nevojshme për aplikim:

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët **Bachelor:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti të nivelit Bachelor;
- Listë notash (të përkthyer në gjuhën angleze nga një përkthyes zyrtar);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (TOEFL/IELS). Universiteti i METU ofron kurset e studimit në gjuhën angleze, dhe niveli minimal i rekomanduar për gjuhën e huaj nga aplikantët është B1. Certifikatat e njohura prej tyre janë TOEFL/IELS. Në mungesë të një prej certifikatave të mësipërme duhet të dorëzoni një certifikatë të gjuhës së huaj të lëshuar nga UT; Për të shkarkuar formatin e certifikatës së gjuhës lëshuar nga UT vizitoni: http://www.unitir.edu.al/images/dokumenta/English_Proficiency_Document.pdf
- Letër Konfirmimi nga UT (e tërhiqni të firmosur pranë rektoratit UT, pasi paraqisni një vërtetim studenti); Për të shkarkuar formatin e Letrës së Konfirmimit vizitoni: http://www.unitir.edu.al/images/dokumenta/Home_University_Confirmation_Letter_Student.pdf
- Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin METU lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni apo frekuentoni lëndët që nuk do të njihen në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, në seksionin e universitetit dërgues që është UT firmoset nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikim: deri më **29 Dhjetor 2016**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në adresën e e-mailit iro@unitir.edu.al me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin METU, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!

Autoritet përgjegjëse për firmosjen e Learning Agreement në nivel fakultetesh.

1- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Albana (Çoni) Shijaku (zv/dekane për ciklin e dytë të studimeve)

2- Fakulteti i Drejtësisë

Kestrin Katro (zv/dekane për anën mësimore) për nivelin BA

3- Fakulteti Ekonomik

Ervin Demo (zv/dekan për Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me Jashtë)

4- Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Cikli i studimit	Programi i studimit	Autoriteti përgjegjës
Bachelor	Biologji	Mirela Lika
Bachelor	Bioteknologji	Klementina Puto
Bachelor	Matematikë	Artur Baxhaku
Bachelor	Fizikë	Polikron Dhoqina
Bachelor	Informatikë	Endri Xhina
Bachelor	Kimi	Kozeta Vaso
Bachelor	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	Rozana Troja
Bachelor	Kimi Industriale dhe Mjedisore	Rozana Troja
Bachelor	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	Fatmir Hoxha
Bachelor	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	Endri Xhina

5- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Andi Pinari (Zv. Dekan për kualifikimin shkencor dhe këshillimin e karrierës.)